KËSHILLI I EUROPËS
GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I KATËRT

ÇËSHTJA DRIZA KUNDËR SHQIPËRISË

(ANKIMI NR.33771/02)

VENDIM
STRASBURG
13 NËNTOR 2007

Në çështjen Driza dhe të tjerë kundër Shqipërisë,

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), me trup gjykues të përbërë prej:

z. NICOLAS BRATZA President
z. J. CASADEVALL
z. G. BONELLO
z. K. TRAJA
z. L.GARLICKI
znj. L.MIJOVIC
z. J.SIKUTA
znj P. HIRVELA gjykatës,

dhe z. T.L.EARLY, regjistrues i seksionit,

pas shqyrtimit me dyer të mbyllura në datën 16 tetor 2007, merr në këtë datë vendimin e mëposhtëm:

PROCEDURA

1. Çështja ka filluar në bazë të ankimit (nr.33771/02) kundër Republikës së Shqipërisë drejtuar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa") nga shtetasi shqiptar, z. Ramazan Driza ("ankuesi"), më 4 shtator 2002.

2. Ankuesi u përfaqësua nga znj. A. Driza-Maurer, vajza e tij dhe avokate, që e ushtron aktivitetin e saj në Gjenevë. Qeveria shqiptare u përfaqësua nga agjentët e saj, z. S. Puto dhe znj S. Mëneri, nga Ministria e Punëve të Jashtme.

3. Ankuesi u ankua në veçanti për shkelje të nenit 6 § 1 në disa aspekte dhe për dështimin në zbatimin e vendimit të formës së prerë dhe në përputhje me nenin 13 të Konventës ai pretendoi se nuk kishte mjete juridike efektive në dispozicion në lidhje me ankimin e mësipërm.

4. Më 5 korrik 2005, Gjykata vendosi t'ia komunikonte ankimin qeverisë. Sipas dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës, ajo vendosi pranimin dhe shqyrtimin në themel të ankimit.

FAKTET

1. RRETHANAT E ÇËSHTJES

5. Ankuesi ka lindur në vitin 1941 dhe jeton në Tiranë (Shqipëri).

6. Procedurat e brendshme përkatëse kanë të bëjnë me një aplikim për kthimin e tokës.

A. Procedurat administrative për kthimin e tokës.

7. Në Shqipërinë e paraluftës i ati i ankuesit ka qenë pronar i një furre buke në Tiranë dhe një parcele toke përkatësisht me 6 000 metra katrorë. Në vitin 1960 shteti shqiptar e shkatërroi ndërtesën dhe shpronësoi tokën.

8. Më 27 shtator të vitit 1994 Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ia ktheu ankuesit të drejtat e pronësisë mbi pronat e të atit të ndjerë, në përputhje me ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronës të vitit 1993 (këtej e tutje referuar si Ligji i Pronës). Vendimi mori formë të prerë më 11 tetor 1994.

9. Në kushtet, kur kthimi në natyrë i ish-pronës ishte i pamundur, më 30 prill 1996 Këshilli Bashkiak i Tiranës vendosi që t'i njohë ankuesit të drejtën e kompensimit për ish-pronën me një pronë të të njëjtit lloj. Prona e alokuar ndodhej në një distancë prej 2 km nga qendra e Tiranës. Ajo kishte një sipërfaqe prej 5 000 metrash katrorë dhe ndahej në 2 parcela, respektivisht, 1 650 m^2 (këtej e tutje referuar si parcela e vogël), dhe 3 350 m^2 (këtej e tutje referuar si parcela e madhe).

10. Me vendimin nr.621, datë 20 qershor 1996 Komisioni i Kthimit dhe i Kompensimit të Pronave (këtej e tutje referuar si "Komisioni i Tiranës") la në fuqi vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës.

11. Më 15 gusht të vitit 2007 titulli i pronësisë së ankuesit u regjistrua në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme në Tiranë.

12. Në vitin 1996 dhe 1997 u dhanë një sërë vendimesh mbi pronësinë e dy parcelave të tokës nga Këshilli Bashkiak i Tiranës dhe Gjykata e Shkallës së parë Tiranë; ankuesi nuk mundi të rimerrte pronat prej poseduesve të tyre.

13. Më 10 shtator të vitit 1997 ankuesi lidhi një kontratë paraprake shitjeje për parcelën e vogël.

B. Procedimet civile në lidhje me parcelën e vogël

1.Procedimet gjyqësore

14. Në bazë të ligjit nr.7501, datë 19 korrik 1991, një anëtari të mëparshëm të kooperativës bujqësore F.Z., iu dha në përdorim parcela e vogël, e cila iu alokua ankuesit më vonë.

15. Në një datë të paspecifikuar F.Z, me anë të një padie civile paraqitur në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, pretendoi titull të plotë pronësie në bazë të ligjit nr.8053, datë 21 dhjetor 1995. Gjithashtu, ajo kërkoi nga gjykata, deklarimin e pavlefshmërisë së vendimit të Komisionit të datës 20 qershor 1996 në lidhje me parcelën e vogël.

16. Më 10 tetor 1997, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, shqyrtoi vendimin e Komisionit, lidhur me parcelën e vogël të tokës dhe vendosi që fillimisht Komisioni duhej të kompensonte përdoruesin e tokës dhe më pas ish-pronarin e saj.

17. Ankuesi me anë të një ankimi drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë, pretendoi titull të plotë pronësie mbi tokën. Ai shpjegoi se, kur Komisioni dha vendimin e tij, parcela ishte pronë shtetërore në dispozicion për t'iu alokuar ish-pronarëve *in lieu* me anë të kompensimit. Ai shtoi se F.Z. ishte thjesht një përdorues i tokës në atë kohë.

18. Më 2 qershor 1998 Gjykata e Apelit Tiranë pranoi ankimin e ankuesit, prishi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për zbatim të keq të ligjit dhe la në fuqi vendimin e Komisionit në lidhje me titullin e pronësisë së ankuesit.

19. Më 17 dhjetor 1998 Gjykata e Lartë-Seksioni Administrativ, gjykoi çështjen në tërësi dhe i njohu ankuesit të drejtën e pronësisë mbi parcelën e vogël e alokuar në kompensim të ish-pronës së mëparshme. Në një datë të paspecifikuar vendimi mori formë të prerë.

2. Rekursi në interes të ligjit

20. Në një datë të paspecifikuar, gjatë vazhdimit të procedurave të ekzekutimit, F.Z

depozitoi një rekurs në interes të ligjit në Gjykatën e Lartë duke kundërshtuar vendimin e 17 dhjetorit të vitit 1998 të Gjykatës së Lartë- Seksioni Administrativ dhe vendimin e 2 gushtit të vitit 1998 të Gjykatës së Apelit, për shkak se vinin në kundërshtim me ligjin material.

21. Rekursi në interes të ligjit u shqyrtua nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Më 5 korrik, përafërsisht dy vjet e gjysëm pas dhënies së vendimit të formës së prerë (1998), Gjykata e Lartë pranoi rekursin. Gjithashtu, në të njëjtën datë, gjykata, me shumicë votash prishi vendimet e 2 qershorit të vitit 1998 dhe të 17 dhjetorit 1998, të cilat ishin në favor të ankuesit, dhe la në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të 10 dhjetorit 1997, vendim i cili kishte rrëzuar pretendimet e ankuesit në lidhje me parcelën e vogël. U konstatua se vendimi i Komisionit ishte bazuar në keqinterpretimin e ligjit të pronësisë (ligji i pronësisë 1993).

22. Ankuesi nuk u vu në dijeni të procesit për rekursin në interes të ligjit dhe nuk u ftua të merrte pjesë në seancat gjyqësore si subjekt procedural. Meqenëse ai nuk u njoh me vendimin e Gjykatës së Lartë brenda 6 muajve nga dita e dhënies së vendimit prej saj, nuk mundi ta apelonte këtë vendim.

23. Nga pesëmbëdhjetë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, të cilët morën pjesë në dhënien e vendimit të 5 korrikut 2001, tre prej tyre (B.C, N.SH, dhe M.S) ishin anëtarë të kolegjit, i cili pas shqyrtimit të çështjes dha vendimin në datën 17 dhjetor të vitit 1998. Përveç kësaj tre prej gjyqtarëve (TH.K., P.Z., dhe V.K.) ishin anëtarë të kolegjit i cili gjykoi çështjen më 7 dhjetor 2000 (shiko në paragrafin më poshtë referuar procedurave në lidhje me të dyja parcelat). Tre gjyqtarët e parë morën pjesë në gjykimin e rekursit në interes të ligjit duke vendosur për keqinterpretimin e ligjit material në vendimin e mëparshëm (1998) të dhënë prej tyre, ndërsa tre gjyqtarët e dytë morën pjesë në shqyrtimin e po këtij rekursi duke vendosur për herë të dytë për të njëjtën çështje.

C. Procedurat gjyqësore në lidhje me pronën në tërësi (të dyja parcelat e tokës)

24. Në vitin 1997 Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke vepruar në emër të tij dhe me kërkesë të S.SH., përdoruesit të parcelës së vogël të tokës alokuar ankuesit, paraqiti një padi përpara Gjykatës së Shkallës së Parë për konstatimin e pavlefshmërisë në tërësi të vendimit të Komisionit të datës 20 qershorit 1996 me arsyetimin se kishte tejkaluar juridiksionin e tij duke i alokuar tokë ankuesit.

25. Më 22 dhjetor 1997 Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë konstatoi pavlefshmërinë e plotë të vendimit të Komisionit, pasi vinte në kundërshtim me ligjin. Gjithashtu vendosi që shteti në bazë të Ligjit të Pronësisë, duhej të kompensonte ankuesin në lidhje me parcelën e tokës me një sipërfaqe prej 5 000 m^2.

26. Në një datë të paspecifikuar ankuesi iu drejtua Gjykatës së Apelit me ankim, duke kërkuar lënien në fuqi të vendimit të Komisionit, i cili i alokonte atij tokën.

27. Më 9 prill 1999 Gjykata e Apelit Tirane rrëzoi apelin e ankuesit dhe la në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë.

28. Në një datë të paspecifikuar ankuesi paraqiti rekurs para Gjykatës së Lartë- Seksioni Civil duke pretenduar që gjykatat e shkallëve më të ulëta nuk kishin konkluduar, se në çfarë titulli e shfrytëzonin tokën përdoruesit.

29. Më 7 dhjetor 2000 Gjykata e Lartë-Seksioni Civil, me anë të një vendimi, la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit me arsyetimin se Komisioni kishte tejkaluar juridiksionin e tij duke vendosur për formën e kompensimit që do të merrte ankuesi si pasojë e humbjes së ish-pronës së tij. Ajo konstatoi se në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave të 13 majit të vitit 1996, komisionet duhej të formoheshin nga këshillat bashkiake dhe duhej të vlerësonin kompensimin në zonat turistike. Komisionet nuk ishin formuar ende. Së fundi, gjykata i njohu të drejtën ankuesit për t'u kompensuar në vlerë në lidhje me një parcelë toke prej 5 000 m^2.

D. Procedurat në Gjykatën Kushtetuese.

30. Ankuesi paraqiti një kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 131 (f) të Kushtetutës duke pretenduar se vendimet e Gjykatës së Lartë të datës 7 dhjetor 2000 dhe i 5 korrikut 2001 ishin antikushtetuese.

31. Më 8 prill 2002, Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 31 të ligjit të organizimit dhe funksionimit të Gjykatës Kushtetuese, vendosi të deklarojë të papranueshme kërkesën, pasi ishte "jashtë juridikisonit" të saj.

E. Zhvillimet e fundit

32. Ankuesi deklaroi se aktualisht mbi parcelën e madhe persona të tretë kishin ndërtuar dhe tashmë i kishin shitur apartamentet të cilat ishin zënë nga pronarët e rinj. Parcela e vogël ishte zënë nga ndërtesa të përkohshme. Ankuesi akoma nuk ishte kompensuar ende nga autoritetet kompetente shqiptare.

II. LIGJI PËRKATËS VENDAS

A.Kushtetuta

35. Kushtetuta shqiptare, lidhur me këtë, citon sa më poshtë :

Neni 41

1. E drejta e pronës private është e garantuar.

2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.

3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë.

4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.

5. Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë.

Neni 42 *2

"Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj."

Neni 142*3

"Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore".

Neni 131

Gjykata Kushtetuese vendos për: ..... f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Neni 181

1. Kuvendi, brenda dy deri tre vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj Kushtetute, nxjerr ligje për rregullimin e drejtë të çështjeve të ndryshme që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera para miratimit të kësaj Kushtetute, duke u udhëhequr nga kriteret e nenit 41.

2. Ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të kesaj

Kushtetute dhe që kanë të bëjnë me shpronësimet dhe konfiskimet, do të zbatohen kur nuk vijnë në kundërshtim me të.

C. Ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave (Ligji nr.7698 i datës 15 prill 1993, ndryshuar me ligjet nr.7736 dhe nr.7765 të vitit 1993, me ligjet me nr. 7808 dhe nr.7879 të vitit 1994, me ligjin nr.7916 të vitit 1995, me ligjin nr.8084 të vitit 1996 dhe shfuqizuar me Ligjin nr.9235 të datës 29 korrik 2004 dhe së fundi ndryshuar me ligjin nr 9235 të vitit 2005 dhe ligjin nr. 9853 të vitit 2006).

36. Ligji për kthimin dhe kompensimin e pronës pësoi disa ndryshime gjatë katërmbëdhjetë viteve të shkuara. Ndryshimet themelore të ligjit të parë të pronës të vitit 1993 ndodhën si rezultat i dy ligjeve, të cilët hynë në fuqi respektivisht në vitin 2004 dhe në vitin 2006, referuar më poshtë respektivisht si "Ligji i pronësisë i vitit 1993", "Ligji i pronësisë i vitit 2004" dhe "Ligji i pronësisë i vitit 2006. Dispozitat përkatëse të secilit prej këtyre ligjeve janë të përmbledhura si vijon më poshtë:

1. Ligji i pronësisë i vitit 1993

37.Sipas ligjit të vitit 1993 ish-pronarëve të shpronësuar nga regjimi përkatës dhe trashëgimtarëve të tyre ligjorë iu njoh e drejta të pretendonin të drejtën e pronës për pronat e origjinës. Pas njohjes të së drejtës së pronësisë, ata kishin ose të drejtën e kthimit të saj në natyrë, ose të drejtën e kompensimit në natyrë (jo më shumë 10 000 m^2) apo në vlerë, nëse plotësonin kushtet e mëposhtme: prona e pretenduar 1) të ishte në formën e kullotës, livadhit, tokës pyjore apo tokës bujqësore dhe jobujqësore; 2) të ishte e patrajtuar nga ligji nr.7501 të datës 19 korrik 1991; 3) të ishte në pronësi të shtetit; 4) dhe në rast se mund të tjetërsohej në truall duke u përfshirë brenda sipërfaqes së vijave të reja kufizuese ndërtimore të qendrave kompensimit: a) me obligacione shtetërore sipas vlerës ekuivalente të pronës, obligacione të cilat do të përdoreshin në versionin e parë për të siguruar aksione në ndërmarrjet shtetërore që po privatizoheshin, ose në sipërmarrje të tilla si kredidhënie; b) me sipërfaqe trojesh ekuivalente pranë qendrave të banuara në përputhje me planet rregulluese të përgjithshme dhe c) me sipërfaqe ekuivalente në zonat turistike, në përputhje me planet rregulluese të përgjithshme. Këshilli i Ministrave përcaktonte rregulla më të hollësishme për mënyrat dhe afatet e kryerjes se këtyre kompensimeve. Gjithashtu, ligji i vitit 1993 parashikonte krijimin e Komisionit të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave si organi administrativ kompetent për të vendosur lidhur me pretendimet e personave për kthimin dhe kompensimin e pronave. Por ky ligj, nuk parashikonte një afat, brenda të cilit vendimet mund të apeloheshin duke sjellë si pasojë moszbatimin e tyre.

2. Ligji i pronësisë i vitit 2004

39. Ligji i pronave i dekretuar në vitin 2004 shfuqizoi ligjin e mëparshëm dhe parashikoi dy forma të kthimit të pronës, më konkretisht, kthimin në natyrë të pronës, nëse plotësoheshin disa kushte dhe kompensimin, në rast të pamundësisë nga ana e autoriteteve për të kthyer në natyrë pronën. Ligji nuk parashikonte kufizime për sipërfaqen e pronës që do të kthehej në natyrë. Ligji parashikonte pesë forma kompensimi: a) me një pronë të të njëjtit lloj, b) me një pronë të një lloji tjetër; c) me aksione në kompanitë shtetërore; d) me vlerën e një prone shtetërore në proces privatizimi; e) me një shumë parash, të cilat i korrespondonin vlerës së pronës në kohën e dhënies së vendimit (neni 11). Ligji krijoi Komitetin Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, të përbërë prej pesë anëtarësh të zgjedhur nga Parlamenti. Roli i tij ishte të vendoste lidhur me ligjshmërinë e vendimeve të dhëna mbi pretendimet e kthimit dhe kompensimit të pronave të komisioneve lokale (neni 15 dhe 17). Këshilli i Ministrave duhej të përcaktonte rregulla dhe kritere më të hollësishme në zbatim të këtij ligji (neni 13).

40. Neni 19 parashikonte për vendimet të cilat caktonin kompensim, ekzekutimin e tyre brenda 6 muajve nga fillimi i çdo viti financiar. Me hyrjen në fuqi të ligjit, çdo person që

pretendonte kthimin apo kompensimin e pronës së tij duhej t'i drejtohej me anë të një kërkese komisionit lokal deri më datën 31 dhjetor 2007. Ligji i dha juridiksion Komisionit për të vendosur në lidhje me formën e kompensimit, megjithëse çdo person në kërkesën e tij mund të përcaktonte preferencën e vet për mënyrën e kompensimit. Vendimet e komisionit lokal mund të apeloheshin para Komitetit Shtetëror (neni 20) dhe më pas para gjykatave të shkallës së parë brenda 30 ditëve nga dhënia e vendimit të Komitetit Shtetëror.

41. Më 28 prill 2005 Parlamenti miratoi një ligj i cili parashikonte mënyrat se si do të vlerësohej prona e paluajtshme, e cila do të kompensohej. Zbatimi i tij iu la Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, i cili do të hartonte hartat për vlerësimin e pronave.

42. Për zbatimin e vendimeve të Komitetit kur caktonte kompensim në para, neni 23 i ligjit të vitit 2004 parashikonte krijimin e një Fondi për Kompensimin e Pronës për një periudhë 10-vjeçare, qëllimi i të cilit ishte sigurimi i mjeteve financiare për kompensime të tilla. Ligji i vitit 2004 u shqyrtua si nga Gjykata Kushtetuese ashtu edhe nga Gjykata e Lartë. Më 24 mars 2005, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konstatuan se Ligji i Pronësisë i vitit 2004 nuk kishte efekt prapaveprues dhe se në këtë mënyrë dispozitat e tij nuk mund të kishin ndikim mbi të drejtat e pronësisë, të njohura nga vendimet administrative ose gjyqësore, të dhëna para hyrjes së tij në fuqi.

3. Ligji i pronësisë i vitit 2006

43. Më 17 korrik 2006, Ligji i Pronësisë së vitit 2004 u ndryshua nëpërmjet Ligjit të Pronësisë së vitit 2006, i cili hyri në fuqi më 17 gusht 2006. Ky ligj parashikonte, ndër të tjera, krijimin e Agjencisë së Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave, një organ i ri, kompetent për të vendosur në lidhje me pretendimet e personave për kthim dhe kompensim të pronës (neni 15). Ligji i ri shfuqizoi nenet 11§2, 19 dhe 20 të ligjit të mëparshëm, i cili, ndër të tjera, përcaktonte procedurën për zbatimin e vendimeve që parashikonin kompensim.

D. Ligji për tokën bujqësore

44. Ligji nr. 8053, i datës 21 dhjetor 1995, iu dha ish-anëtarëve të kooperativave bujqësore të drejtën për të kërkuar titullin e pronësisë së tokës që ata kishin punuar.

E DREJTA

1. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

45. Ankuesi u ankua për shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në disa aspekte duke argumentuar se prishja e një vendimi të formës së prerë ishte në kundërshtim me parimin e sigurisë jurdike; se Gjykata e Lartë kishte qenë e njëanshme gjatë dhënies së vendimit; dhe se autoritetet nuk kishin zbatuar vendimin e formës së prerë të dat[s 17 dhjetor 1998 dhe të datës 7 dhjetor 2000.

Neni 6 § 1, për sa kohë që është i zbatueshëm, vijon si më poshtë:

Në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile…, çdo person ka të drejtë të dëgjohet drejtësisht brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë.

A. Pranueshmëria

1. Pajtueshmëria me rregullin gjashtëmujor

46. Qeveria arsyetoi se ankimi ishte i papranueshëm, pasi ishte bërë jashtë afatit gjashtëmujor të parashikuar në nenin 35 § 1 të Konventës. Kështu, për shkak të karakterit diskrecionar të proçedurave në Gjykatën Kushtetuese dhe vendimit të papranueshmërisë de plano të kësaj të fundit në çështjen aktuale, rregullimi përfundimtar efektiv brenda kuptimit të nenit 35 ishin në fakt vendimet e Gjykatës së Lartë të datës 5 korrik 2001 (faza e parë e procedimeve) dhe të datës 7 dhjetor 2000 (faza e dytë e procedimeve), ndërsa ankuesi paraqiti kërkesën e tij para Gjykatës më 4 shtator 2002.

47. Si përgjigje, duke iu referuar nenit 131 (f) të Kushtetutës dhe praktikës së Gjykatës Kushtetuese, ankuesi u shpreh se me qëllim shterrimin e të gjithave mjeteve juridike të brendshme, individët duhet të paraqisnin një ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese, nëse pretendonin një shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë (neni 6 i Konventës). Për më tepër, ankesa lidhej me konceptin e një gjykate të paanshme, shkeljen e parimit të sigurisë juridike dhe mosekzekutimin e vendimeve të formës së prerë, të cilat ishin në juridiksion të Gjykatës Kushtetuese, përcaktuar kjo në jurisprudencën e saj. Gjykata Kushtetuese kishte juridiksionin dhe detyrimin për të shqyrtuar çështjen dhe për të vendosur mbi të me anë të një vendimi nëse do të ishte e nevojshme. Kështu që, ankuesi pretendoi se e kishte paraqitur kërkesën para Gjykatës në kohë, duke pasur parasysh se vendimi i Gjykatës Kushtetuese ishte i datës 8 prill 2002, edhe pse ishte një vendim papranueshmërie *de plano*.

48. Gjykata nënvizoi se e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe e drejta për një vendim të formës së prerë të ekzekutueshëm, të cilat përbëjnë shqetësimin kryesor të ankuesit, janë të drejta kushtetuese të parashikuara në nenet 31 dhe 42 të Kushtetutës.

49. Gjithashtu Gjykata nënvizoi përfundimet e saj në këtë çështje në lidhje më Shqipërinë duke konkluduar, se ankesa pranë Gjykatës Kushtetuese mund të konsiderohej një mjet juridik efektiv që duhet të përdorej për qëllime të nenit 35 të Konventës, sa herë që ngriheshin çështje për një proces të rregullt ligjor (neni 6). Ajo çmoi, se nuk ka arsye për të devijuar nga ky konkluzion në rrethanat e kësaj çështjeje (shiko Qufaj k. Shqipërisë, nr. 54268/00, § 42, të dt. 18 nëntor 2004 dhe Balliu k. Shqipërisë vendimi nr. 74727/01 shtator 2004).

50. Ajo konstatoi se vendimi përfundimtar ishte ai i datës 8 prill 2002. Meqenëse ankuesi paraqiti kërkesën e tij më 4 shtator 2002, ai është në pajtim me afatin gjashtëmujor të parashikuar nga neni 35.

51.Për këto arsye, Gjykata hedh poshtë kundërshtimin e qeverisë.

2. Rregullsia e procesit: shkelja e parimit të sigurisë juridike dhe të paanshmërisë së gjykatës.

52. Ankuesi pretendoi se Gjykata e Lartë (Kolegjet e Bashkuara) shkeli nenin 6 § 1 të Konventës, gjatë shqyrtimit të rekursit në interes të ligjit duke prishur vendimin e formës së prerë të datës 17 dhjetor 1998 dhe vendimin e Komisionit të datës 20 qershor 1996. Gjithashtu, ai u ankua për mungesën e paanshmërisë së panelit të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dy drejtime kryesore: tre prej gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë (TH.K., P.Z. dhe V.K.) ishin dy herë anëtarë të trupit gjykues, i cili vendosi në disfavor të ankuesit më 5 korrik 2001 dhe më 7 dhjetor 2000; gjithashtu ai përmendi rolin e dyfishtë të kryetarit të Gjykatës së Lartë gjatë procesit të rekursit në interes të ligjit.

53. Qeveria e kundërshtoi këtë pretendim.

54. Gjykata çmon se kjo pjesë e ankimit nuk është haptazi e pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Më tej vëren se nuk ka shkaqe për mospranueshmërinë e saj, kështu ajo deklarohet e pranueshme.

3. Mosekzekutimi i vendimeve përfundimtare të datës 17 dhjetor 1998 dhe të datës 7 dhjetor 2000

55. Qeveria shqiptare pretendoi se, ndërkohë që ankuesi nuk pranoi rezultatin përfundimtar të proçeseve gjyqësore, ai nuk tregoi interes në ekzekutimin e vendimit të datës 7 dhjetor 2000; ai nuk kërkoi fillimin e proçedurave të ekzekutimit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe daljen e urdhrit të ekzekutimit të vendimit në fjalë. Gjithashtu, ai nuk përdori mjetet juridike të parashikuara në Ligjin e Pronësisë të vitit 2004 përsa i takon kompensimit. Qeveria shqiptare argumentoi se pretendimet e ankuesit duhet të deklaroheshin të papranueshme për shkak të mosshterrimit të mjeteve jurdike të brendshme.

56. Ankuesi kundërshtoi efektivitetin e mjeteve jurdike të referuara nga qeveria. Ai

argumentoi se Ligji i Pronësisë i vitit 2004 nuk siguronte mjete juridike në kuptimin e Konventës. Ai vërejti se të drejtat e tij të pronësisë ishin përcaktuar në vendimet përfundimtare të datës 17 dhjetor 1998 dhe të datës 7 dhjetor 2000, kështu që një organ administrativ nuk mund të rishqyrtonte të njëjtën çështje. Së fundi, ai pohoi se nëse gjykata vendase do të kishte urdhëruar kompensim në një nga format e parashikuara nga ligji, përmbaruesit nuk do të kishin qenë në gjendje ta ekzekutonin atë vendim. Varet nga autoritetet shtetërore impelementimi i masave efektive, qoftë nëpërmjet kalsifikimit të pronave shtetërore që do të përdoren për kompensim në natyrë, qoftë duke siguruar fonde të mjaftueshme buxhetore për kompensim financiar, me qëllim që kjo mënyrë ndreqjeje të realizohet. Në përfundim, ankuesi i qëndroi mendimit se qeveria deri tani nuk kishte marrë hapa efektivë për të gjetur zgjidhje në lidhje me çështjen e kompensimit të pronave ish-pronarëve.

57. Gjykata theksoi se rregulli i shterrimit të mjeteve juridike të brendshme, referuar nenit 35 § 1 të Konventës, detyron ankuesit të përdorin të gjitha mjetet juridike që në sistemin ligjor vendas janë normalisht në dispozicion dhe të mjaftueshme për t'i mundësuar ata të sigurojnë rivendosjen e së drejtës që pretendohet se është shkelur. Mjetet juridike ekzistuese duhet të jenë mjaftueshmërisht të besueshme, si në praktikë dhe në teori. Është përgjegjësi e shtetit ta sigurojë këtë garanci, pasi në të kundërt këto mjete nuk do të mund të përdoren sipas nevojave dhe do të mbeten fiktive (shih vendimin eVernillo v. France te dt.20 shkurt 1991, Seria A, nr.198, fq 11-12, § 27; Aksoy v.Turkey, nr.21987/93, §§ 51-52, Reports 1996-VI; dhe Akdivar and others v. Turkey. nr.21893/93, §§ 65-67, Reports 1996-IV).

58. Gjykata çmon se problemi i efektivitetit të mjeteve juridike të parashikuara në Ligjin e Pronësisë përbën një ndër pretendimet kryesore të ankuesit sipas nenit 13 në kuptim të nenit 1 të protokollit nr.1. Ajo vëren, se të dyja këto probleme duhen shqyrtuar se bashku në themel.

B. Themeli

1. Rregullsia e procesit

a) Siguria juridike: Prishja e vendimit të formës së prerë

i) Parashtrimet e palëve

59. Ankuesi pretendoi se qeveria kishte shkelur parimin e sigurisë juridike në dy raste të ndryshme. Në radhë të parë, duke përdorur një procedim të tipit Brumărescu, rezultat i së cilës ishte prishja e vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 17 dhjetor 1998 i cili linte në fuqi pjesërisht vendimin e Komisionit të dt. 20 Gusht 1996; dhe në radhë të dytë, duke dhënë vendime kontradiktore në një set proçesesh paralele, duke mos marrë parasysh vendimet e mëparshme të formës së prerë. Në të vertetë, vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 7 dhjetor 2000 që kundërshtoi në tërësi vlefshmërinë e vendimit të Komisionit të datës 20 qershor 1996, nuk mori parasysh përfundimet e vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 17 dhjetor 1998.

60. Me pak fjalë, duke dhënë vendime kontradiktore në një set proçesesh paralele, të cilat pjesërisht apo plotësisht prishnin vendimet e mëparshme të formës së prerë, sistemi ligjor shqiptar tregoi pamajftueshmëri, pasojë e së cilës ishte shkelja e parimit të sigurisë juridike. Gjithashtu, pavarësisht faktit se instituti i rekursit në interes të ligjit ishte shfuqizuar, ankuesi ishte akoma viktimë e shkeljeve të pretenduara nga ky institut ligjor.

61. Qeveria e kundërshtoi këtë argument. Ajo pohoi se gjatë periudhës qershor-korrik 1997 gjykatat vendase ishin të legjitimuara për të filluar gjykimin e dy çështjeve civile të pavarura nga njëra-tjetra dhe të vendosnin mbi ligjshmërinë e vendimit të Komisionit të datës 20 qershor 1996 duke qenë se ishin vënë në lëvizje nga palë të ndryshme dhe kishin vendosur për çështje të ndryshme.

62. Për sa i përket rekursit në interes të ligjit, qeveria argumentoi se rishqyrtimi i një vendimi të formës së prerë brenda një afati kohor prej 3 vjetësh, pasi ky vendim kishte marrë

formë të prerë, parashikohej nga legjislacioni i brendshëm i asaj kohe. Qëllimi i këtij mjeti ishte korrigjimi i atyre vendimeve të formës së prerë, të cilat ishin dhënë në kundërshtim me ligjin e brendshëm gjatë periudhës së tranzicionit dhe rrjedhimisht pati një efekt të përkohshëm deri në vitin 2001, kur u shfuqizua. Realisht, duke pasur parasysh se në lidhje me çështjen konkrete ishin dhënë dy vendime gjyqësore kontradiktore, rishqyrtimi nga një gjykatë më e lartë për të vendosur përfundimisht në lidhje më çështjen ishte i domosdoshëm. Kjo gjë u realizua me dhënien e vendimit të datës 5 korrik 2001 nga Gjykata e Lartë, vendim i cili përputhej me përfundimet e vendimit të datës 7 dhjetor 2000.

ii) Vlerësimet e Gjykatës

63. Parimi i sigurisë jurdike përpara një gjykate garantuar nga neni 6 § 1 i Konventës duhet interpretuar nën dritën e preambulës së Konventës, e cila shpall që shteti i së drejtës do jetë trashëgimia e përbashkët e shteteve kontraktuese. Një ndër aspektet themelore të shtetit të së drejtës është edhe parimi i sigurisë juridike, i cili kërkon mbi të gjitha që, kur gjykatat, për një çështje të caktuar japin një vendim i cili merr formë të prerë, më pas, këto vendime nuk duhet të vihen në dyshim (shih Brumărescu v. Romania [GC], nr. 28342/95, § 61, EHCR 1999-VII; Ryabykh v. Russia, nr.52854/99, §§ 51-56. EHCR 2003-IX; Roşca v. Moldava, nr. 6267/02, § 24,22 Mars 2005).

64. Siguria juridike presupozon respektimin e parimit të gjësë së gjykuar (shih Brumărescu v. Romania të cituar më lart, § 62), i cili është parimi kryesor i një vendimi të formës së prerë. Ky parim konsiston në faktin që asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rigjykimin e një çështjeje që është zgjidhur me vendim të formës së prerë thjesht, sepse do të donin një rishqyrtim të çështjes së tyre. E drejta e gjykatave më të larta në shqyrtimin e ankimeve në lidhje me vendimet e gjykatave më të ulëta të cilat kanë marrë formë të prerë, duhet të përqendrohet në ndreqjen e gabimeve apo pasaktësive gjyqësore, dhe jo në rigjykimin në themel të çështjes. Ndreqja e gabimeve apo pasaktësive nuk duhet të trajtohet si një simulim në të vërtetë i ankimit, dhe mundësia e të paturit të dy vendimeve për të njëjtën çështje nuk përbën justifikim për një rishqyrtim të ri. Shmangia nga ky parim justifikohet vetëm kur vërtetohen rrethana thelbësore dhe të pakonstatueshme, se një gjë e tillë rezulton e domosdoshme (shih Roşca v. Moldava cituar më lart, §25).

65. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, Gjykata vëren se më 17 dhjetor 1998, Gjykata e Lartë, Seksioni Administrativ la në fuqi njohjen e së drejtës së pronës së ankuesit mbi parcelën e vogël të tokës. Pavarësisht kësaj, më 7 Dhjetor 2000 Seksioni Civil i Gjykatës së Lartë, në një set proçesesh gjyqësore paralele, konstatoi se titulli i pronësisë ishte dhënë në kundërshtim me ligjin. Gjithashtu, më 5 korrik 2001, në bazë të kërkesës së kryetarit të Gjykatës së Lartë që me anë të rekursit në interes të ligjit të rimerrej sërisht në shqyrtim vendimi gjyqësor i vitit 1998, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pa u referuar në përfundimet e vendimit të vitit 2000, prishën vendimin e formës së prerë të datës 17 Dhjetor 1998 në dëm të ankuesit. Me pak fjalë, pas 2 vjetësh e 7 muajsh vendimi i Gjykatës së Lartë i dt.17 Dhjetor 1998 u prish për herë të dytë nga Gjykata e Lartë, një herë nga një vendim i dhënë nga një set procesesh gjyqësore paralele dhe herën e dytë me anë të rekursit në interes të ligjit. Si rezultat problemi i pronësisë së ankuesit mbetet akoma i pazgjidhur.

66. Gjykata vëren se vendimi i vitit 1998 u prish për herë të parë gjatë procedurës të rekursit në interes të ligjit, i cili i mundësoi kryetarit të Gjykatës së Lartë të kundërshtonte çdo vendim të formës së prerë në lidhje me çështjen, në bazë të kërkesës së një prej palëve ndërgjyqëse. Ky procedim parashikohej në nenin 473 të Kodit të Procedurës Civile, i cili ishte në fuqi deri më 17 maj 2001.

67. Gjykata nuk pajtohet me argumentat e qeverisë në lidhje me efektin e kufizuar të institutit të rekursit në interes të ligjit. Shfuqizimi i këtij mjeti ligjor pasi rrodhën disa fakte në lidhje me çështjen, është pa kuptim: nuk ekzistojnë mjete juridike të brendshme të afta për të

rivendosur të drejtat e cenuara si rezultat i shkeljes së parimit të sigurisë jurdike, rrjedhojë kjo e përdorimit të procedurës të rekursit në interes të ligjit, efektet e të cilit nuk u korrigjuan kurrë në çështjen konkrete (shiko Sardin v. Russia vendimi nr. 69582/01, EHCR 2004-II; Ryabykh v. Russia vendimi nr. 52854/99, i datës 21 shkurt 2002).

68. I njëjti vendim u prish për herë të dytë nga një vendim i dhënë në një set procesesh paralele. Gjykata kundërshton argumentat e qeverisë se autoritetet ishin të legjitimuara për të filluar dy procese paralelisht në mënyrë të ndarë, në lidhje me të njëjtën çështje. Ajo rikujton nëpërmjet nenit 1 përgjegjësinë kryesore të shteteve për implementimin dhe zbatimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (shiko Kudla v. Poland [GC], nr. 30210/96 § 152, ECHR 2000-XI)

69. Për këtë arsye, është përgjegjësia e shteteve kontraktuese për organizimin e legjislacionit të tyre në mënyrë të tillë që proceset e lidhura me njëra-tjetrën të identifikohen dhe aty ku është e nevojshme të bashkohen në të njëjtin proces ose për më tepër të ndalohet fillimi i proceseve të reja që kanë lidhje me të njëjtën çështje, për të shmangur rigjykimin e vendimeve të formës së prerë duke simuluar në fakt ankimin e tyre nën dritën e proceseve paralele.

70. Gjykata çmon se, duke i dhënë kryetarit të drejtën për të lejuar rigjykimin e një vendimi të formës së prerë dhe duke lejuar përdorimin e proceseve gjyqësore paralele, Gjykata e Lartë nuk mori fare parasysh të gjithë procesin gjyqësor, rezultat i të cilit ishte një vendim gjyqsor që në fakt përbënte *res judicata*. Kështu që duke pasur parasysh rrethanat e mësipërme, Gjykata nuk sheh ndonjë arsye për të ndarë përfundimet e veta në çështjen në fjalë (shiko paragrafet 63-64 më sipër).

71. Gjykata çmon se ka shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për arsye se është prishur një vendim i formës së prerë i datës 17 dhjetor 1998 i dhënë në favor të ankuesit.

b) Paanshmëria

1. Parashtrimet e palëve

72. Ankuesi u ankua në bazë të nenit 6 § 1 për mungesën e paanshmërisë së panelit të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Kështu, tre prej gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë (TH.K., P.Z. dhe V.K.) ishin dy herë anëtarë të trupit gjykues, i cili vendosi në disfavor të ankuesit më 5 korrik 2001 dhe më 7 dhjetor 2000. Gjithashtu, kryetari i Gjykatës së Lartë, i cili paraqiti një kërkesë për rekurs në interes të ligjit në lidhje me vendimin e dhënë në favor të ankuesit, ishte gjithashtu dy herë pjesë e trupit gjykues që vendosi në disfavor të tij në procese të ndryshme.

73. Qeveria e kundërshtoi këtë argument. Ajo pohoi se duke iu referuar legjislacionit të brendshëm të asaj kohe, Gjykata e Lartë gjykonte ose në kolegje me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë (kolegj civil/penal) ose me trup gjykues të përbërë nga të gjithë gjyqtarët (kolegje të bashkuara). Kolegjet e Bashkuara mund të shprehen, ndër të tjerash, në lidhje me kërkesat për rekurs në interes të ligjit dhe për çështje të rëndësishme. Kështu që, në këndvështrimin e qeverisë, funksionimi i Kolegjeve të Bashkuara do të dëmtohej nëse gjyqtarët pjesëmarrës në kolegjin me trup gjykues prej 5 gjyqtarësh nuk do të ishin pjesë e Kolegjeve të Bashkuara. Ajo iu referua vendimit të Gjykatës Kushtetues të Dhjetor 7 prill 2000, i cili përcakton se funksionimi i Gjykatës së Lartë me të gjithë anëtarët e saj, si një trup vendimmarrës, është në përputhje me kërkesat për një trup gjykues të paanshëm. Së fundi, qeveria parashtroi se ankuesi nuk kishte arritur të provonte pretendimet në lidhje me mungesën e paanshmërisë së tre gjyqtarëve të sipërpërmendur.

i) Vlerësimet e Gjykatës

74. Gjykata pohoi se ka rëndësi themelore, që në një shoqëri demokratike gjykata të përcjellë besim tek qytetarët (shih Padovani v. Italy, vendimi i dt. 26 shkurt 1993, Seria A nr.257-B p.20). Neni 6 kërkon, që një gjykatë brenda juridiksionit të saj të jetë e paanshme. Paanshmëri do të thotë mungesë paragjykimi, apo anësie dhe ekzistenca e saj mund të provohet

në mënyra të ndryshme. Kështu, Gjykata ka evidentuar dallimin midis kriterit subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit, që bindja personale apo interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës, dhe kriterit objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse ai apo ajo ofruan garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm (shih Piersack v. Belgium, vendimi i datës 1 tetor 1982, Seria A nr.53, § 30 dhe Kyprianou v. Cyprus [GC], nr. 73797/01, § 118-119, ECHR 2005-…).

75. Gjykata ka deklaruar vazhdimisht se në kuptim të kriterit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta (shiko, për shëmbull, Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere v. Belgium, vendim i datës 23 qershor 1981, Seria A nr 43, p.25, § 58).

76. Përsa i përket kriterit të dytë, nëse ky kriter zbatohet për anëtarët e trupit gjykues, ai nënkupton se, veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet, nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër edhe dukja e jashtme mund të ketë një farë rëndësie (shiko Castillo Algar v. Spain, vendimi i datës 28 tetor 1998, Raporti 1998-VIII, p.31116, § 45 dhe Morel v. France, nr. 34130/96, § 42, ECHR 2000-VI). Në përcaktimin, nëse në një çështje konkrete ka arsye logjike për të dyshuar që një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që ankohen për diçka të tillë është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Në fakt, vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshmërisht i bazuar (shiko Ferrantelli dhe Santangelo v. Italy, vendim i datës 7 gusht 1996, Reports 1996-III, pp. 951-52, § 58, dhe Ëettstein v. Sëitzerland, nr. 33958/96, § 44, CEDH 2000-XII; Kyprianou v. Cyprys [GC], nr 73797/01, §§ 118 -119, ECHR 2005).

77. Në çështjen konkrete, ankuesi vuri në dyshim si paanshmërinë subjektive ashtu edhe atë objektive të tre gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, kështu që Gjykata do ta shqyrtojë secilin me radhë.

78. Në lidhje me paanësinë personale të gjyqtarëve P.Z. dhe V.K., Gjykata nuk konstaton ndonjë provë për të konfirmuar pretendimet e ankuesit. Ndërsa për Th.K., kryetarin e Gjykatës së Lartë, Gjykata vëren se, në përputhje me legjislacionin shqiptar të kohës kur është gjykuar çështja, procedurat e rekursit në interes të ligjit kishin filluar me kërkesë të kryetarit të Gjykatës së Lartë, i cili kishte vendosur tashmë në disfavor të ankuesit (seti i dytë i procedurave). Gjykata e Lartë, kryetari i së cilës ishte anëtar, së bashku me 14 gjyqtarë shqyrtuan kërkesën dhe vendosën prishjen e vendimit të formës së prerë, i cili ishte në favor të ankuesit. Gjykata është e mendimit, se kjo praktikë e Gjykatës së Lartë Shqiptare nuk ishte e pajtueshme me kriterin e “paanësisë subjektive” të një gjyqtari që shqyrton një çështje, përderisa askush nuk mund të jetë në të njëjtën çështje paditës dhe gjyqtar (shiko Svetlana Naumeko v. Ukraine nr.41984/98, § 97. datës 9 nëntor 2004).

79. Për sa i përket paanshmërisë objektive, shqetësimet në lidhje me paanshmërinë e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, burojnë prej faktit, se trupi gjykues përbëhej prej pesëmbëdhjetë gjyqtarësh, gjashtë prej të cilëve kishin gjykuar çështjen në themel më përpara duke dhënë vendimet e datës 17 dhjetor 1998 dhe 7 dhjetor 2000.

80. Gjykata pranon, që situata mund të ketë ngjallur dyshime tek ankuesi në lidhje me paanshmërinë e Gjykatës së Lartë. Megjithatë, duhet shqyrtuar nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshmërisht i provueshëm. Përfundimi lidhur me këtë varet prej rrethanave të çështjes.

81. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se, në përputhje me legjislacionin e brendshëm lidhur me rekursin në interes të ligjit, Gjykata e Lartë duhet të shqyrtonte çështjen me të gjithë anëtarët e saj. Tre prej gjyqtarëve, të cilët kishin dalë me një vendim për çështjen, ishin pjesë e Kolegjeve të Bashkuara, që do të vendosnin nëse do ta pranonin kërkesën për rekurs në interes të ligjit dhe rrjedhimisht për themelin e çështjes. Si pasojë të tre gjyqtarët do të vendosnin nëse kishin gabuar në vendimin e tyre të mëparshëm apo jo. Për më tepër, tre gjyqtarë të tjerë të

trupit gjykues duhet të vendosnin në lidhje me çështjen për të cilën ata e kishin dhënë njëherë sentencën e tyre.

82. Në këto kushte Gjykata konstaton, se paanshmëria objektive e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, lë shkas për dyshime. Kështu që dyshimi i ankuesit në lidhje më këtë problem mund të konsiderohet mjaftueshmërisht i bazuar.

83. Duke marrë parasysh gjithë sa u parashtruan më sipër, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë nuk ishte e paanshme përsa i përket dy konstatimeve të mësipërme në kuptim të nenit 6 § 1 të Konventës.

c) Konkluzione

84. Duke iu referuar konstatimeve të mësipërme, Gjykata çmon se është shkelur e drejta e ankuesit për një gjykim të drejtë nga një trup gjykues i paanshëm në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës.

2. Mosekzekutimi i vendimeve të formës së prerë të datës 17 dhjetor 1998 dhe të datës 7 dhjetor 2000

d) Parashtrimet e palëve

85. Qeveria shqiptare i qëndroi mendimit se autoritetet shqiptare nuk mund të konsideroheshin përgjegjëse për mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të sipërpërmendura, duke qenë se ekzekutimi varej nga ndërmarrja e hapave të nevojshëm nga ana e ankuesit, konkretisht: paraqitja e kërkesës për ekzekutim të vendimit para gjykatës kompetente. Qeveria iu referua argumenteve të saj të mëparshme mbi përdorimin e të gjitha mjeteve të brendshme juridike.

86. Ankuesi e kundërshtoi këtë argument.

e) Vlerësimet e Gjykatës

87. Parimet e përgjithshme në lidhje me moszbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të cilat caktonin kompensim, duke përfshirë edhe kompensim në natyrë në përputhje me skemën e kthimit të pronave, janë parashtruar në vendimin Beshiri (cituar më sipër § 60).

88. Gjykata çmon se vendimet e Gjykatës së Lartë të datës 17 dhjetor 1998 dhe të datës 7 dhjetor 2000, mund të interpretohen si detyrim i autoriteteve shqiptare për t'i siguruar ankuesit një formë kompensimi në natyrë ose në vlerë, e cila do ta zhdëmtonte atë *in lieu* për ish-pronën e tij.

89. Gjykata nuk e pranoi këndvështrimin e qeverisë përsa i përket mungesës së interesimit të ankuesit për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore; në fakt ankuesi kishte kundërshtuar rezultatin e procedimeve që çuan në vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 7 dhjetor 2000.

90. Gjykata vëren se, ashtu si edhe në vendimin Beshiri, duke u marrë me dhënien e vendimit të vitit 2000, autoritetet nuk i ofruan ankuesit mundësi për të marrë kompensimin e duhur në përputhje me vendimin e mëparshëm gjyqësor të formës së prerë (shiko në kontrast, Užkurėlienė etj v. Lithuania, nr. 62988/00, § 36, 7 prill 2005). Kështu që ankuesi nuk pati asnjë mundësi për të shqyrtuar një ofertë kompensimi në raport të drejtë me kthimin në natyrë të pronës. Për më tepër, duke prishur dy herë radhazi vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 17 dhjetor 1998, autoritetet nuk përmbushën detyrimet që buronin nga një vendim gjyqësor i formës së prerë.

91. Gjithashtu, Gjykata çmon që qeveria nuk ka dhënë asnjë shpjegim se, përse vendimi i datës 7 dhjetor 2000 nuk është ekzekutuar ende, edhe pse kanë kaluar 6 vjet nga shpallja e tij. Nuk ka të dhëna, që përmbaruesit gjyqësorë apo autoritetet administrative të kenë marrë ndonjë masë në zbatim të këtij vendimi.

92. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se ky problem vazhdon të ekzistojë pavarësisht përfundimeve të dhëna në vendimet Qufaj Co. sh.p.k dhe Beshiri (shiko Qufaj Co. sh.p.k., të cituar më lart, § 54-59, dhe Beshiri etj., cituar më lart, § 109).

92. Konsideratat e mësipërme janë të mjaftueshme për t'i dhënë mundësi Gjykatës të konstatojë, se mosmarrja e masave të nevojshme për të ekzekutuar vendimin e dt 7 Dhjetor 2000, autoritetet shqiptare i zhveshën dispozitat e nenit 6 § 1 të Konventës nga të gjitha efektet e dobishme.

93. Pra ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR.1 TË KONVENTËS.

95. Ankuesi pretendoi se prishja e vendimit të Komisionit dhe e vendimit gjyqësor të formës së prerë të datës 17 dhjetor 1998, pa i dhënë ankuesit kompensim, përbën shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1, i cili parashikon:

"Çdo person fizik ose juridik ka të drejtë të gëzojë paqësisht pronën që disponon. Askush nuk mund të privohet prej disponimit të pronës së tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndëkombëtare.

Megjithatë, parashikimet e mësipërme nuk do të cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, të cilat ata i gjykojnë të domosdoshme për të kontrolluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave a të kontributeve të tjera, ose të gjobave."

A. Pranueshmëria

96. Gjykata çmon se ankimi sipas këtij kreu nuk është haptazi i pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Për më tepër ajo vëren, se nuk ka gjetur ndonjë arsye për ta deklaruar këtë pjesë të ankimit si të papranueshëm dhe kështu e deklaron atë të pranueshëm.

B. Themeli

1. Parashtrimet e palëve

97. Duke iu referuar vendimeve gjyqësore të brendshme në lidhje me çështjen, qeveria pretendoi se ankuesi nuk mund të kërkonte mbrojtje sipas këtij neni, duke qenë se vendimi i komisionit i akordoi atij dy pacela toke në vend të ish-pronës së tij, të cilën ankuesi nuk e posedoi kurrë. Pavarësisht faktit, që ankuesi e regjistroi titullin e tij të pronësisë në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme, në bazë të legjislacionit të brendshëm, një titull pronësie që jepej me anë të vendimeve të Komisonit mund të kundërshtohej para një gjykate pa iu nënshtruar ndonjë afati kohor. Në të vërtetë, vendimi i mësipërm u kundërshtua në gjykatën e brendshme, e cila konstatoi pavlefshmërinë absolute të titullit dhe urdhëroi, që ankuesi të kompensohej për ish-pronën e tij. Për më tepër, në këndvështrimin e qeverisë, vendimi i formës së prerë i Gjykatës së Lartë, i cili la në fuqi vendimin e Komisionit në lidhje me parcelën e vogël nuk mund të konsiderohet njohje absolute e së drejtës së pronësisë, pasi ndërkohë, që një set tjetër procesesh gjyqësore po shqyrtonin vlefshmërinë e këtij titulli (shiko më sipër 24-29).

98. Gjithashtu, qeveria pohoi se meqenëse ankuesi nuk e pranoi rezultatitn e proceseve gjyqësore në lidhje me ligjshmërinë e titullit të tij mbi dy parcelat e tokës, autoritetet shqiptare nuk mund të deklaroheshin përgjegjëse, përderisa ankuesi nuk paraqiti para autoriteteve kompetente kërkesën për kompensim në përputhje më Ligjin e Pronësisë.

99. Qeveria shtoi gjithashtu, se pamundësia për të ekzekutuar vendimet gjyqësore të formës së prerë, që jepnin kompensim në kuadër të kthimit dhe kompensimit të pronave ishte për shkak të rrethanave objektive, si mungesa e fondeve dhe ndikimi i tyre mbi interesin e përgjithshëm të komunitetit.

100. Ankuesi pretendoi se deklaratat e qeverisë ishin të pabazuara. Ai parashtroi, se vendimi i Gjykatës së Lartë i vitit 2000 përbënte një kufizim të së drejtës së pronësisë së tij jo sipas një interesi publik. Për më tepër, ai pretendoi, se pas më shumë se 12 viteve procedurash administrative dhe gjyqësore civile, të drejtat e tij në bazë nenit 1 të protokollit nr. 1 nuk u respektuan. Ankuesi parashtroi se shteti ishte përgjegjës për borxhet e papaguara ndaj tij, të

tilla si kompensimi dhe duke mos arritur të paguante ato borxhe për një kohë të gjatë, shteti e kishte privuar atë nga e drejta për të poseduar realisht pronën, në shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1.

2.Vlerësimet e Gjykatës

101. Gjykata rikujton parimet e mëposhtme të përcaktuara në jurisprudencën e saj sa i takon nenit 1 të protokollit nr.1 (mes të tjerash shiko Kopecký v. Slovakia [GC], nr. 44912/98, § 35; von Maltzan etj v. Germany (dec) [GC], nr. 71916/01, nr.71917/01 dhe nr 10260/02, § 74, ECHR 2005-V dhe Beshiri e cituar më lart).

102. Gjykata rithekson se "pasuritë" mund të jenë "pasuri ekzistuese" ose "asete", përfshirë në disa raste të përcaktuara qartë, edhe pretendimet. Që një pretendim të konsiderohet "aset" në përputhje me nenin 1 të protokollit nr.1, duhet që pretenduesi të provojë se në legjislacionin vendas ekziston një bazë e mjaftueshme, për shembull kur ekziston një praktikë e konsoliduar e gjykatave vendase në mbështetje të këtij pretendimi, ose kur ekziston nje vendim gjyqësor i formës së prerë në favor të pretendimeve të ankuesit. Kur kjo arrihet të provohet hyn në veprim koncepti i "pritshmërisë së ligjshme" (shiko Dragon v. France [GC], nr. 1513/03, § 68, 6 tetor 2005, ECHR 2005-IX, dhe Burdov v. Russia, nr 59498/00, § 40, ECHR 2000-III).

103. Gjykata vëren se ankuesi ka paraqitur një padi rivendikimi në lidhje me ish-pronën e tij në përputhje me Ligjin e Pronësisë. Autoritetet deklaruan, se shtetëzimi i pronës së babait të tij ishte i kundërligjshëm, dhe i alokuan atij me anë të kompensimit dy parcela toke me sipërfaqe prej 5 000 m^2 në vend te ish-pronës së tij me sipërfaqe prej 6 000 m^2. Megjithë ndërhyrjen e autoriteteve shtetërore, ankuesi nuk e mori kurrë posedimin e tokës, përderisa ajo u zu nga persona të tretë. Asnjëra prej palëve nuk komentoi ngjarjet, që ndodhën gjatë periudhës që pasoi dhënien e vendimit të Gjykatës së Lartë të vitit 1998, i cili la në fuqi të drejtën e pronësisë së ankuesit mbi parcelën e tokës me sipërfaqe prej 1 650 m^2. Në vitin 2001 dhe 2000 u dhanë dy vendime gjyqësore njëra si rezultat i procedurës të rekursit në interes të ligjit, dhe tjetri rezultat i proceseve paralele, të cilat deklaruan pavlefshmërinë e titullit të pronësisë së ankuesit mbi të dyja parcelat e tokës dhe urdhëruan kompensimin e tij në një nga mënyrat e parashikuara në ligj. Që nga ajo datë ankuesi nuk është kompensuar ende.

104. Pavarësisht, se të dyja parcelat e tokës u regjistruan në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme dhe e drejta e tij e pronësisë mbi parcelën e vogël të tokës u la në fuqi me një vendim gjyqësor të formës së prerë, i cili u përmbys më vonë me procedurën e rekursit në interes të ligjit, Gjykata nuk mund të hamendësojë, nëse ankuesi ka patur ndonjëherë nën zotërim ndonjërën nga parcelat apo jo, ose për gjendjen aktuale. Kështu që, me qëllim shqyrtimin e ankimit do të konsiderohet, që ankuesi ka pasur një "pretendim" në përputhje me nenin 1 të protokollit nr.1.

105. Gjykata vëren se kjo pjesë e ankimit ka lidhje me atë të shqyrtuar në bazë të nenit 6 §1 të Konventës, në lidhje me mos-zbatimin e vendimeve të formës së prerë (shiko më lart paragrafët 85-94).

106. Gjykata konstaton se në çështjen konkrete autoritetet kanë detyrimin, që në bazë të vendimeve të datës 17 dhjetor 1998 dhe të datës 7 dhjetor 2000, të kompensojnë ankuesin respektivisht në natyrë dhe në vlerë në raport të drejtë me ish-pronën e tij. Kështu që ankuesi ka të drejtë të pretendojë zbatimin e detyrimeve, që rrjedhin nga vendimet gjyqësore në fjalë.

107. Gjykata çmon se moszbatimi i vendimeve të formës së prerë të datës 17 dhjetor 1998 dhe të datës 7 dhjetor 2000, përbën një ndërhyrje në të drejtën e ankuesit për një gëzim të qetë të pronës së tij në kuptimin e nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës.

108. Përsa i përket justifikimit të parashtruar nga qeveria për këtë ndërhyrje, Gjykata rikujton se mungesa e fondeve nuk mund të justifikojë mosekzekutimin e një vendimi detyrues të formës së prerë për shlyerje borxhi (shih Pasteli and Others v. Moldova nr.9898/02, 9863/02, 6255/02 dhe 10425/02, § 30, 15 qershor 2004, Voytenko v.Ukraine, nr 18966/02, §

55. 29 Qershor 2004; Shmalko v. Ukraine, nr 60750/00, § 57, 20 korrik 2004).

109. Për pasojë ka pasur shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës lidhur me kompensimin.

III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 13 I MARRË BASHKËRISHT ME NENIN 1 TË PROTOKOLLIT NR.1.

110. Ankuesi u ankua për mungesën e mjeteve efektive juridike për të siguruar një përcaktim përfundimtar të së drejtës së tij të pronësisë. Ai iu referua nenit 13 të Konventës, i cili vijon si më poshtë:

"Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të bëjë ankim efektiv tek një organ i vendit të tij, edhe kur shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare".

111. Kështu, që gjykata do të shqyrtojë këtë pjesë të ankimit sipas nenit 13 i marrë së bashku me nenin 1 të protokollit nr.1 të Konventës. Për këtë problem, gjykata ka ndërthurur pjesën e ankimit në lidhje me shterrimin e mjeteve juridike të brendshme me atë të moszbatimit të vendimeve sipas nenit 6 (shiko paragrafin 58 më lart).

A. Pranueshmëria

112. Gjykata çmon se ankimi, sipas këtij kreu, nuk është haptazi i pabazuar sipas kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Për më tepër ajo vëren, se nuk ka gjetur ndonjë arsye për ta deklaruar këtë pjesë të ankimit si të papranueshme dhe kështu e deklaron atë të pranueshme.

B. Themeli

1. Parashtrimet e palëve

113. Ankuesi parashtroi se mjeti i vetëm i siguruar nga legjislacioni shqiptar për kthimin dhe kompensimin e pronave, më konkretisht paraqitja e një kërkese para organit kompetent sipas Ligjit të Pronësisë nuk mund të konsiderohet "efektiv" në kuptim të qëllimit të nenit 13. Edhe nëse një kërkesë e tillë përmbushej me sukses, kthimi dhe/ose kompensimi i pronës së origjinës në të vërtetë ishte në diskrecionin e autoriteteve kompetente dhe varej nga vullneti i tyre për të zbatuar parashikimet e nevojshme lidhur me këtë çështje.

114. Qeveria e kundërshtoi këtë argument të ankuesit, në veçanti duke përsëritur argumentin në lidhje me neglizhencën e ankuesit në ezaurimin e mjeteve të brendshme juridike. Ajo vuri në dukje se legjislacioni shqiptar parashikonte një mjet juridik të veçantë, me anë të të cilit ankuesi mund të pretendonte kthimin dhe kompensimin e pronës së tij, nëse ajo ishte shtetëzuar dhe i ishte konfiskuar në mënyrë të kundërligjshme nga shteti. Skema ligjore në lidhje me çështjen e kthimit dhe të kompensimit i është nënshtruar ndryshimeve të shumta ligjore për shkak të pasojave të konsiderueshme financiare dhe sociale të këtij procesi. Megjithatë, pavarësisht ndryshimeve ligjore, që çuan në përmirësimin e këtij procesi, tre mjetet juridike të parashikuara nga Ligjet e Pronësisë ishin në përputhje me kërkesat e nenit 13 të Konventës. Megjithatë, qeveria sugjeroi, pa dhënë shpjegime të mëtejshme, që ankuesi duhet t'i ishte drejtuar autoritetit kompetent të parashikuar nga Ligji i Pronësisë së vitit 2004 me anë të një kërkese për të siguruar zhdëmtim.

2. Vlerësimi i Gjykatës

115. Gjykata vëren se ankimi i ankuesit në bazë të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës përbën në mënyrë të padiskutueshme "objekt shqyrtimi". Për rrjedhojë ankuesi gëzonte të drejtën e një mjeti juridik të brendshëm efektiv sipas kuptimit të nenit 13 të Konventës.

116. Për më tepër, Gjykata rikujton se "autoriteti" i përmendur në nenin 13 nuk mund të jetë domosdoshmërisht në të gjitha instancat një autoritet gjyqësor në kuptimin e ngushtë të këtij termi. Sidoqoftë, kompetencat dhe garancitë proceduriale, që disponon një autoritet janë të rëndësishme për të përcaktuar, nëse mjeti juridik, që ka në dispozicion ankuesi është efektiv ose

jo (shiko Klass and others v. Germany, vendimi i dt.6 shtator 1978, Seria A nr. 28, p. 30, § 67). Mjeti juridik, sipas kuptimit të nenit 13 duhet të jetë "efektiv" si në praktikë ashtu edhe në teori, në veçanti, në kuptimin, që përdorimi i tij të mos pengohet në mënyrë të paligjshme nga veprimet apo mosveprimet e autoriteteve të shtetit në fjalë (shih Aksoy v. Turkey, vendimi i datës 18 dhjetor 1996, Reports of Judgments and Decisions 1996-VI, p. 2286, § 95 në fund).

117. Gjykata vëren, se në vijim, të tre Ligjet e Pronësisë, parashikuan një mjet juridik, në formën e një veprimi për kthim dhe kompensim të pronës adresuar një organi administrativ të posaçëm, i cili kishte në kompetencë të vendoste në lidhje me titullin e pronësisë së ish-pronarëve dhe aty ku ishte e mundur t'iu alokonte atyre pronën e tyre të origjinës ose t'i kompensonte ata *in lieu*. Procedura e mësipërme është mënyra e vetme për të fituar të drejtën e pronësisë në lidhje me pronën, e shtetëzuar në kundërshtim me ligjin. Ankuesi e përdori këtë mjet, dhe në dy raste autoritetet i njohën të drejtën për t'u kompensuar në lidhje me ish-pronën e babait të tij (shih paragrafët 9-10 më sipër).

118. Gjykata vëren se Ligji i Pronësisë i vitit 1993 (shfuqizuar me Ligjin e Pronësisë së vitit 2004 dhe ndërkohë i ndryshuar nga Ligji i Pronësisë i vitit 2006) parashikonte forma të ndryshme kompensimi, kur prona e origjinës nuk mund t'i kthehej në natyrë pronarit (shih paragrafët 36-43 më sipër). Gjykata konstaton se Ligji i Pronësisë i vitit 1993, e linte në kompetencë të Këshillit të Ministrave, përcaktimin e formës së duhur të kompensimit, i cili duhet të hartonte rregullat dhe mënyrat e mëtejshme për kompensimin, në zbatim të ligjit. Duke iu referuar përfundimeve në vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 7 dhjetor 2000, organi kompetent, i cili do vendoste në lidhje me çështjen e kompensimit nuk ishte formuar akoma në atë kohë (shiko paragrafin 29 më sipër). Pavarësisht, se Ligji i Pronësisë së vitit 2004 hyri në fuqi, situata nuk ndryshoi. Vetëm më 28 prill 2005, Parlamenti nxori një ligj, i cili përcaktonte skemën në lidhje me vlerësimin e pronës për qëllime kompensimi. Neni 5 i këtij ligji la zbatimin e kësaj skeme në kompetencë të Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, i cili do të hartonte hartat për vlerësimin e pronave. Megjithatë deri më sot këto harta akoma nuk janë hartuar.

119. Rrjedhimisht, Gjykata çmon se, duke mos u krijuar organet kompetente, të cilat do të vendosnin në lidhje me problemin e kompensimit dhe duke mos u hartuar hartat për vlerësimin e pronave, Qeveria nuk mundi të krijonte një procdurë të përshtatshme në lidhje me kërkesat për kompensim. Për më tepër, është e pamundur që nëpërmjet këtyre sistemeve kaq të shpejta apo brenda një harku kohor relativisht të shkurtër, shteti të mundësojë zgjidhjen e çështjes duke dhënë një përcaktim përfundimtar në lidhje me të drejtat e ankuesit.

120. Rrjedhimisht, duke rikujtuar përfundimet në vendimin Beshiri, Gjykata konstaton se ankuesit i është mohuar e drejta për një mjet juridik efektiv në lidhje me pretendimet e tij, e cila përbën shkeje të nenit 1 të protokollit nr.1 (shih Beshiri etj. të cituar më sipër, §§ 54, 55).

121. Pra, është shkelur neni 13 i Konventës i marrë bashkërisht me nenin 1 të protokollit nr.1 të Konventë. Për rrjedhojë,Gjykata hedh poshtë kundërshtimet e qeverisë.

IV. ZBATIMI I NENEVE 46 DHE 41 TË KONVENTËS

A. Neni 46 i Konventës

121. Neni 46 i Konventës parashikon:

"1. Palët e larta kontraktuese zotohen t'u binden vendimeve përfundimtare të Gjykatës në çdo rast, kur ata janë palë.

2. Vendimi përfundimtar i Gjykatës i transmetohet Komitetit të Ministrave i cili mbikëqyr zbatimin e tij.''

122. Gjykata vëren se përfundimet e saj të lartpërmendura (shih paragrafët 117-118), tregojnë se zvarritja e pajustifikuar e kompensimit, sipas Ligjit të Pronësisë, nuk mund t'i

atriubuohet ndonjë sjelljeje të veçantë të ankuesit. Kjo zvarritje erdhi si pasojë e ekzistencës së vakuumit në legjislacionin shqiptar, si rrjedhim i së cilit një kategori e tërë individësh u privuan nga e drejta për gëzimin paqësor të pronës, si pasojë e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore, të cilat caktonin kompensim në përputhje me Ligjin e Pronësië. Në të vërtetë, tashmë janë paraqitur dyzina me kërkesa identike para Gjykatës përsa i përket këtij problemi. Përshkallëzimi i numrit të kërkesave është një faktor rëndues përsa i përket përgjegjësisë së shtetit në bazë të Konventës, dhe përbën kërcënim për efikasitetin në të ardhmen të sistemit të vendosur nga Konventa, kështu që sipas këndvështrimit të Gjykatës, vakumi ligjor i zbuluar në çështjen konkrete të ankuesit, mund t'i japë jetë një numri të shumtë kërkesash të tjera të bazuara.

123. Përpara shqyrtimit të pretendimeve individuale të ankuesit për shpërblim të drejtë, sipas nenit 41 të Konventës dhe duke pasur parasysh rrethanat e çështjes konkrete, Gjykata dëshiron të marrë në konsideratë efektet e nenit 46 për shtetin e paditur. Gjykata rithekson se, sipas nenit 46, shtetet kontraktuese duhet t'u binden vendimeve përfundimtare të Gjykatës në mosmarrëveshjet ku ata janë palë, mbikëqyrja e ekzekutimit të të cilave është në kompetencë të Komitetit të Ministrave. Një ndër efektet e këtij neni është: aty ku Gjykata konstaton shkelje, shteti i paditur ka detyrimin ligjor, jo vetëm të shlyejë detyrimet monetare në kuadër të shpërblimit të drejtë konform nenit 41, por duhet të përzgjedhë, subjektin që do të mbikëqyret nga Komiteti i Ministrave, masat e përgjithshme dhe/ose kur është e përshtatshme masat e veçanta që duhet të ndërmerren në sistemin e brendshëm të së drejtës, pët t'i dhënë fund shkeljeve të konstatuara nga Gjykata dhe të korrigjojë sa më shpejt të jetë e mundur efektet e tyre. Për më tej, që prej momentit kur Gjykata konstaton mangësi në sistemin ligjor, autoritetet kombëtare, subjekt i mbikëqyrjes prej Komitetit të Ministravel, kanë detyrimin të ndërmarrin brenda një afati kohor të caktuar-me fuqi prapavepruese nëse është e mundur- (shih ndër autoriteteve të tjera Xenides-Arestis v. Turkey, nr, 46347/99, §§ 39, 40, 22 Dhjetor 2005: Scordino v. Italy (nr.1) [GC], nr. 36813/97, § 233. ECHR 2006 dhe Bronioëski v. Poland [GC], nr.31443/96, § 192, ECHR 2004-V; Bottazzi v. Italy [GC], nr 34884/97, § 22, ECHR 1999-V, Di Mauro v. Italy [GC], nr 34256/96, §23, ECHR 1999-V), masat e nevojshme për t'i korrigjuar këto mangësi në përputhje me parimin e subsidiaritetit, sipas Konventës, me qëllim që Gjykata të mos ripërsërisë përfundimet e veta për shkeljen në fjalë në një seri të gjatë çështjesh të ngjashme.

124. Në këtë kontekst, si pjesë e masave të parashikuara për të garantuar efektivitetin e makinerisë së vendosur nga Konventa, Gjykata dëshiron të verë në dukje Rezolutën (Res(2004)3) dhe Rekomandimin (Rec(2004)6) te Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës të miratuara më 12 maj 2004.

125. Në teori nuk është Gjykata ajo që duhet të përcaktojë se kush mund të jenë masat e duhura për korrigjim, në mënyrë që shteti i paditur të veprojë në përputhje me detyrimet e tij sipas nenit 46 të Konventës. Megjithatë, një ndër shqetësimet e Gjykatës është lehtësimi i rrethanave që do të mundësojnë një shtypje të shpejtë dhe efektive të keqfunksionimit të konstatuar në sistemin vendas, që garanton mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në këtë kontekst duke iu referuar edhe gjendjes së konstatuar më sipër, Gjykata çmon se duhet të ndërmerren masa të përgjithshme në nivel kombëtar, të cilat janë padyshim të nevojshme për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore aktuale

126. Për të asistuar në zbatimin e detyrimeve sipas nenit 46 nga shteti i paditur, Gjykata është përpjekur të parashtrojë llojin e masave, që shteti shqiptar duhet të ndërmarrë për t'i dhënë fund natyrës dhe shkaqeve të shkeljeve të gjetura në çështjen në fjalë. Gjykata çmon se shteti i paditur, mbi të gjitha, duhet të heqë të gjitha pengesat që bëhen shkak për kompensimin sipas Ligjit të Pronësisë, duke mundësuar marrjen e të gjitha masave ligjore, administrative dhe buxhetore të domosdoshme Këto masa duhet të përfshijnë hartimin e hartave

për vlerësimin e pronës për ankuesit të cilët kanë të drejtë të marrin kompensim në natyrë, si dhe përcaktimin e një fondi të përshtatshëm për ankuesit që përfitojnë kompensim në vlerë, me qëllim që të gjithë ata pretendues, të cilët kanë në duar vendime gjyqësore në favorin e tyre, vendime të cilat u njohin atyre të drejtën e kompensimit sipas Ligjit të Pronësisë të përfitojnë pa vonesë shumën e kompensimit ose truallin. Këto masa duhet të vihen në dispozicion sa më parë.

B. Neni 41 i Konventës

127. Neni 41 i Konventës parashikon:

"Kur Gjykata konstaton shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese mundëson vetëm ndreqjen e pjesshme të pasojave të shkaktuara nga shkelja, Gjykata kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar."

1. Dëmi

128. Ankuesi fillimisht pretendoi kthimin e plotë të të dy parcelave të tokës (me sipërfaqe 5 000 m^2) dhe gjithashtu shumën prej 186 000 euro për fitimin e munguar. Meqenëse kthimi i ish-tokës së tij ishte i pamundur, ai pretendoi në lidhje me të 5 779 000 euro përsa i përket dëmit pasuror dhe fitimit të munguar. Ai u mbështet në një raport vlerësimi ekspertësh, për qëllime të përcaktimit të vlerës së përgjithshme të pasurive të tij dhe fitimit të munguar. Sipas këtij raporti ish-prona ndodhet në një zonë urbane shumë të zhvilluar të Tiranës. Prona kishte akses të mirë me rrugët kryesore dhe kishte një potencial ekonomik të mirë, i cili u shfrytëzua për qëllime ndërtimi. Raporti ndër të tjera konstatonte, se vlera e tregut në lidhje me tokën varionte nga 400 euro për m^2 në 2000 euro për m^2 në varësi të faktit se për çfarë ishte destinuar. Së fundi, ankuesi pretendoi 70 000 euro për dëmin jopasuror.

129. Qeveria kundërshtoi pretendimet e ankuesit, por nuk parashtroi asnjë argument në lidhje me shumat e pretenduara nga ankuesi. Ajo pohoi angazhimin e saj për të gjetur një zgjidhje në lidhje me kthimin dhe kompensimin e pronës. Në këtë mënyrë qeveria i rikujtoi Gjykatës rregullin se konstatimi i një shkelje përbënte në vetvete një zhdëmtim të drejtë.

130. Gjykata rithekson se një vendim nëpërmjet të cilit ajo konkludon se ka pasur shkelje, vendos shtetin e paditur para detyrimit ligjor sipas Konventës për t'i dhënë fund shkeljes dhe për të riparuar pasojat e saj në mënyrë të tillë që të rivendoset sa më shpejt të jetë e mundur situata ekzistuese siç ishte para shkeljes (shih Former King of Greece and the Others v. Greece [GC] (zhdëmtim i drejtë), nr 25701/94, § 72). Nëse legjislacioni i brendshëm mundëson vetëm riparim të pjesshëm të dëmit, neni 41 i Konventës i jep Gjykatës kompetencë për të kompensuar palën e dëmtuar për veprimin apo mosveprimin që u bë shkak i shkeljes se konstatuar. Gjykata gëzon një lloj diskrecioni në ushtrimin e kësaj kompetence, siç provohet dhe nga përdorimi i fjalës "i drejtë" dhe frazës " nëse është e nevojshme".

131. Midis çështjeve që Gjykata merr parasysh kur vlerësohet kompensimi, janë dëmi pasuror (humbja aktualisht e shkaktuar si rezultat i drejtëpërdrejtë i shkeljes së pretenduar) dhe dëmi jopasuror (kompensim për ankthin, vështirësitë dhe pasigurinë e shkaktuar nga shkelja) dhe dëme të tjera jopasurore (shih, midis autoriteteve të tjera Ernestina Zullo v. Italy nr.64897/01, § 25, 10 nëntor 2004). Për më tepër, nëse një ose më shumë kategori specifike të dëmit nuk mund të llogariten saktësisht ose nëse dallimi midis dëmit pasuror dhe jopasuror duket i vështirë, Gjykata mund të vendosë të bëjë një vlerësim total (shih Comingerstoll v. Portugal [GC], nr. 35382/97, § 29. ECHR 2000-IV).

132. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, Gjykata çmon se vendimi gjyqësor i formës së prerë i datës 7 dhjetor 2007, i njohu ankuesit pronësinë mbi parcelën e tokës me sipërfaqe prej 5 000 m^2. Kështu që pretendimi i ankuesit në lidhje me prona të ndryshme nga ato që iu alokuan atij, konsiderohet *ultra petita*, dhe si pasojë nuk pranohet.

133. Për më tepër, Gjykata çmon se në çështjen në fjalë u konstatua shkelje të nenit 6 § 1 të nenit 1 të protokollit të parë shtesë nr.1 dhe të nenit 13 të Konventës, duke zbuluar se

ankuesi u pengua në gëzimin e qetë të pronës së tij osë me anë të kompensimit *in lieu*. Gjykata çmon se ankuesit i është shkaktuar një dëm i konsiderueshëm pasuror dhe jopasuror si rezultat i shkeljes së të drejtave të tij të afirmuara në Konventë, e cila është dhe arsyeja se pse konstatimi qoftë edhe i një shkeljeje të vetme nuk mund të përbëjë mjaftueshmërisht një zhdëmtim të drejtë sipas kuptimit të nenit 41 të Konventës.

134. Gjithashtu, duke iu referuar konkluzioneve të saj në vendimet më të fundit që janë dhënë nga Gjykata, ku parashtrohet se autoritetet shqiptare duhet të merrnin masa të përshtatshme me qëllim pajtimin me vendimet e formës së prerë (shih Qufaj Co. Sh.p.k cituar më sipër, § 54-59, dhe gjithashtu, Beshiri etj., cituar më sipër § 109), dhe në mungesë të adoptimit të mjeteve të brendshme në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të kompensimit që nga dhënia e këtyre vendimeve, Gjykata çmon se nuk i mbetet mundësi tjetër përveçse të caktojë një shpërblim, i cili do të përbëjë një rregullim të plotë dhe përfundimtar të problemit të pronësisë (shih, midis autoriteteve të tjera Plotnikovy v.Russia, nr. 43883/02, § 33, 24 shkurt 2005 dhe OOO Rusatommet v. Russia, nr.61651/00, § 33, 14 Qershor 2005).

135. Gjykata çmon se, në rrethanat e çështjes në fjalë, kthimi i parcelës së vogël të tokës, ashtu siç u caktua me vendimin gjyqësor të formës së prerë të Gjykatës së Lartë të datës 17 dhjetor 1998, së bashku me pagimin e fitimit të munguar, si dhe të kompensimit në vlerë në lidhje me parcelën e madhe të tokës në bazë të vendimit të datës 7 dhjetor 2000, duke përfshirë edhe shkallën e interesit që pasqyron ndërhyrjen, pasojë e së cilës ishte humbja e pronësisë së parcelës së madhe të tokës, do ta vendosnin ankuesin sa më shpejt të jetë e mundur në një situatë të njëjtë me atë në të cilën do të kish qenë ai po të mos kishim shkelje të Konventës.

136. Përsa i përket shumës së kompensimit, Gjykata vëren se qeveria as nuk parashtroi një metodë vlerësimi sipas këndvështrimit të saj dhe as nuk paraqiti ndonje kundërshtim përsa i përket metodës së vlerësimit të kompensimit të parashtruar nga ankuesi.

137. Duke iu referuar informacionit të disponueshëm sipas vlerësimit të ankuesit në lidhje me çmimet e tregut të tokës në Tiranë në kohën kur janë dhënë vendimet gjyqësore përkatëse dhe duke bërë një vlerësim të paanshëm, Gjykata i jep ankuesit një shumë prej 500 000 euro përsa i përket dëmit pasuror dhe jopasuror në lidhje me parcelën e madhe të tokës.

138. Gjithashtu, Gjykata i jep ankuesit një shumë totale prej 50 000 euro së bashku me kthimin e parcelës së vogël të tokës. Në rast se shteti i paditur dështon në kthimin e kësaj parcele ankuesit brenda tre muajve nga data në të cilin ky vendim merr formë të prerë, atëherë Gjykata vendos që shteti detyrohet t'i paguajë ankuesit, një shumë prej 280 000 euro përsa i përket dëmit pasuror dhe jopasuror në lidhje me këtë parcelë.

2. Kostot dhe shpenzimet

139. Ankuesi gjithashu pretendoi 5 000 euro për kostot dhe shpenzimet para gjykatave kombëtare dhe 1 000 euro para Gjykatës. Ai nuk dha analizë të detajuar për vërtetimin e pretendimeve të tij në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

140. Qeveria e kundërshtoi pretendimin duke e konsideruar si të ekzagjeruar.

141. Gjykata përsëriti se kostot dhe shpenzimet nuk do të rimbursohen në bazë të nenit 41, në rast se nuk provohet se ato janë paguar aktualisht, ishin të nevojshme të paguheshin dhe kanë qenë të arsyeshme përsa i përket sasisë (shih The Sunday Times v. the United Kongdom (neni 50), vendimi i datës 6 nëntor 1980, Seria A nr. 38, p. 13, § 23.) Gjithashtu kostot ligjore janë të rimbursueshme për sa kohë ato kanë lidhje me shkeljen e konstatuar (shiko Beyler v. Italy, (zhdëmtim) [GC], nr 33202/96, § 27, 28 maj 2002).

142. Gjykata konstaton se këto shpenzime të pretenduara nuk janë provuar me anë të dokumenteve përkatëse se janë paguar. Në këtë mënyrë ajo nuk do t'i rimbursojë ato.

3. Interesi i mospagimit

Gjykata çmon të nevojshme se interesi i mospagimit duhet të bazohet në normën

marzhinale të huadhënies të Bankës Qendrore Europiane, së cilës duhet t'i shtohen tre pikë për qind.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA UNANIMISHT:

1. I deklaron ankesat në lidhje me nenin 6 § 1 të Konventës (për sa i përket shkeljes së parimit të sigurisë juridike, paanshmëris së trupit gjykues dhe moszbatimit të një vendimi të formës së prerë) dhe nenin 1 të protokollit shtesë nr.1 të Konventës vetëm dhe së bashku me nenin 13 të Konventës, të pranueshme;

2. Konstaton, se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, për sa i përket parimit të sigurisë juridike, si rrjedhim i prishjes së vendimit të datës 17 dhjetor 1998, nga Gjykata e Lartë me anë të procedurës të rekursit në interes të ligjit dhe të proceseve paralele;

3. Konstaton, se përsa i përket vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 5 korrik 2001 mbi themelin e çështjes, ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me mungesën e paanësisë subjektive të kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe mungesën e paanësisë objektive të Gjykatës së Lartë;

4. Konstaton, se ka pasur shkelje të nenit 1 të protokollit të parë shtesë të Konventës përsa i përket moszbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të datës 17 dhjetor 1998 dhe të datës 7 dhjetor 2000;

5. Konstaton, se ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës i marrë së bashku me nenin nr.1 të protokollit nr.1 për sa i përket joefektivitetit të mjeteve jurdike të parashikuara nga Ligji i Pronësisë;

6. Vlerëson se:

a) Shteti i paditur duhet t'i kthejë ankuesit brenda 3 muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë në pajtim me nenin 44 § 2 të Konventës, parcelën e tokës me sipërfaqe 1 650 m^2, si dhe t'i paguajë shumën prej 50 000 euro (pesëdhjetë mijë euro) në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror përsa i përket kësaj parcele, e cila do të konvertohet në monedhën vendase të shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes, duke përfshirë edhe ndonjë taksë që mund të jetë e tatueshme;

b) Nëse nuk realizon kthimin e tokës së mësipërme, shteti i paditur detyrohet t'i paguajë ankuesit 280 000 euro (dyqind e tetëdhjetëmijë) në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror, brenda gjashtë muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë, në pajtim me nenin 44 § 2 të Konventës. Kjo shumë duhet të konvertohet në monedhën vendase të shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes, duke përfshirë edhe ndonjë taksë që mund të jetë e tatueshme;

c) Shteti i paditur duhet t'i paguajë ankuesit, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë, në pajtim me nenin 44 § 2 të Konventës, shumën prej 500 000 euro (pesëqindmijë) në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror përsa i përket parcelës së tokës me sipërfaqe prej 3 350 m^2, e cila duhet konvertuar në monedhën vendase të shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes, duke përfshirë edhe ndonjë taksë që mund të jetë e tatueshme;

d) Që nga skadimi i afatit të sipërpërmendur prej gjashtë muajsh (përsa i përket pikës (a) dhe (b), dhe prej tre muajsh (përsa i përket pikës (c)) interesi i thjeshtë i shlyerjes do të jetë i pagueshëm mbi shumat e mësipërme në një normë të barabartë me normën marzhinale të huadhënies së Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre pikë për qind.

8. Hedh poshtë pjesën e mbetur të pretendimeve të ankuesit për zhdëmtim të drejtë.

Përgatitur në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 13 nëntor 2007, sipas rregullit 77 § 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

T.L EARLY
Kryesekretar

Josep CASADEVALL
President